



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština – Municipality of Prishtina**



---

Duke u bazuar në Strategjinë nacionale për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, Planit të Veprimit për zbatimin e strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, Shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr. 0-43 të datës 16.01.2023, Komuna e Prishtinës shpall:

## **KONKURS**

**Për plotësimin e pozitave për anëtar të Komitetit Komunal Veprues nga radhët e organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare**

**Kabineti i Kryetarit**

**Zyra për Komunitete dhe të Drejtat e Njeriut,**

**Titulli i vendit të punës: Anëtar i Komitetit Komunal Veprues,**

**Lloji i Vendit të Punës: Vullnetar (pa kompensim financiar),**

**Numri i Pozitës: Katër (4) ekzekutues (dy anëtarë të organizatave ndërkombëtare dhe 2 anëtarë të organizatave të shoqërisë civile të fokusuar në përmirësimin e gjendjes të komuniteteve joshumicë),**

**Kohëzgjatja e emërimit: Tre vite (3), duke u bazuar në Strategjinë nacionale për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, e cila është në fuqi deri në vitin 2026.**

**Detyrat dhe roli i anëtarit të Komitetit Komunal Veprues:**

- Të bashkëpunoj me autoritetet lokale dhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile për zbatimin dhe monitorimin e strategjisë nacionale për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Prishtinës;
- Të merr pjesë aktive në takimet e Komitetit Komunal Veprues;
- Të monitoroj aktivitetet e parapara në planin lokal të veprimit për avancimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës;

- Të kontribuojë në iniciimin e miratimit të politikave tjera lokale, të cilat do të kontribuonin në zbatimin e planit lokal të veprimit për avancimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës;
- Të koordinojë aktivitetet me institucionet e nivelit qendror dhe organizatat e shoqërisë civile për zbatimin e planit lokal të veprimit për avancimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës;
- Të zhvillon aktivitete me partnerë tjerë për alokime të fondeve për zbatimin e planit lokal të veprimit për avancimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës;

## **II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve**

Përzgjedhja e kandidatëve nga organizatat e shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare do të jetë publike dhe transparente. Do të merren parasysh kriteret, si vijon:

- Kandidatët nga radhët e organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare, të cilët punojnë me sukses më shumë se tri (3) vite në fushën e avancimit të komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare;
- Kandidatët nga radhët e organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare, të cilat kanë programe/projekte të qëndrueshme në fushën e avancimit të komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare;
- Kandidatët nga radhët e organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare që monitorojnë aktivitetet e komuniteteve joshumicë në Komunën e Prishtinës;
- Kandidatët nga radhët e organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare që kanë njohuri të mjaftueshme për monitorimin dhe vlerësimin e planeve dhe projekteve të caktuara;

## **Kriteret e kualifikimit për anëtar të Komitetit Komunal Veprues**

- Diplomë universitare;
- Përvoja minimale e punës trevjeçare në fushën e avancimit të komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare;

## **I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Rezumeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diploma universitare e kualifikimit;
- Certifikatën e regjistrimit të organizatës që përfaqësojnë;
- Dëshmi të përvojës të punës.

Vetëm kandidatët me kriteret e plotësuar do të ftohen në intervistë.

### **III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.**

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Diplomat e kandidatëve kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë publikohet në web faqen e Komunës të Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/> (konkurset) dhe përmes e-mailit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen. Ndërsa, origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

### **Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më **27.02.2023 deri më datën 12.03.2023**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.